


Një projekt nga Agjencia
Zvicerane për Zhvillim dhe
Bashkëpunim SDC

 Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim
dhe Bashkëpunim SDC



Në partneritet me:



Zbatuar nga:



HELVETAS



PARTNERSALBANIA
FOR CHANGE AND DEVELOPMENT

PËRMBAJTJA

1 Qëllimi	3
2 Konteksti	4
3 Vështrim i përgjithshëm mbi zgjidhjen: Qasje e besueshme për furnizimin e qëndrueshëm	6
4 Aspektet e tregut	10
5 Mundësitë në nivel biznesi	11
6 Histori suksesi	14
7 Thirrje për veprim	15

Autor: ERGENT PIRE
Menaxher Ndërhyrjesh, Helvetas

Deklaratë për Mohimin e Përgjegjësisë: Ky dokument është hartuar nga RisiAlbania, një projekt për punësimin e të rinjve, i mbështetur nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe i zbatuar nga Helvetas në partneritet me Partnerët Shqipëri. Pikëpamjet dhe përfundimet e paraqitura në këtë dokument nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht qëndrimet zyrtare të Qeverisë Zvicerane apo të Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC).

Gusht 2025

Qëllimi

Qëllimi i propozimit të biznesit në fjalë është evidentimi i përfitimeve që burojnë nga përdorimi i sistemeve të gjurmueshmërisë në sektorin e fruta-perimeve (F&P) dhe bimëve mjekësore dhe aromatike (BMA) në Shqipëri, duke i kushtuar vëmendje të veçantë përdorimit të FarmForce - një platformë e njohur në nivel botëror – si dhe futjes në përdorim të një sistemi lokal të zhvilluar nga kompania Heliuss System. FarmForce ka rezultuar e suksesshme në mbështetjen e kompanive në vendet në zhvillim për të hyrë në tregjet ndërkombëtare me vlerë të lartë, duke garantuar transparencën dhe përputhshmërinë rregulatore përgjatë të gjithë zinxhirit të furnizimit.

Heliuss Systems, një kompani shqiptare në fushën e zhvillimeve teknologjike, ka zhvilluar një sistem të posaçëm për gjurmueshmërinë në sektorin e frutave dhe perimeve dhe të bimëve mjekësore dhe aromatike (BMA), duke përfaqësuar kështu përpjekjen e parë lokale në këtë fushë. Sistemi u ngrit me mbështetjen e projektit të punësimit të të rinjve (RisiAlbania) të Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC, zbatuar nga Helvetas dhe Partners Albania. Megjithëse Heliuss Systems ka shfaqur potencial dhe aftësi për t'u përshtatur, sistemi i tyre i gjurmueshmërisë është i ri në treg dhe aktualisht mungojnë të dhënat e mjaftueshme për të vlerësuar ndikimin financiar ose për të nxjerrë përfundime të vlefshme në lidhje me përfitimet afatgjata.

Me rritjen e konkurrencës në tregun global dhe ashpërsimin e kërkesave për eksport - veçanërisht sa i takon aspekteve të gjurmueshmërisë, qëndrueshmërisë dhe respektimit të rregulloreve përkatëse – futja në përdorim e instrumenteve moderne digjitale nga kompanitë shqiptare të fruta-perimeve dhe BMA-ve është kthyer në domosdoshmëri. Gjurmueshmëria qëndron në thelb të këtij evolucioni, duke bërë të mundur që kompanitë të arrijnë të përmbushin pritshmëritë e blerësve dhe konsumatorëve për informacion të verifikueshëm dhe të detajuar në lidhje me origjinën, cilësinë dhe ndikimin mjedisor të produkteve të tyre.

Një sistem i fuqishëm si FarmForce ofron një zgjidhje të plotë për menaxhimin dhe gjurmimin e prodhimit nga ferma deri te produkti përfundimtar. Ai rrit transparencën, mbështet përputhshmërinë me certifikimet ndërkombëtare dhe përmirëson efikasitetin operacional si në proceset e kultivimit ashtu edhe përgjatë zinxhirit të furnizimit. Në sajë të veçorive të tyre, si mbledhja e të dhënave në kohë reale, ruajtja digjitale e të dhënave dhe raportimi i automatizuar, sistemet e gjurmueshmërisë zvogëlojnë ndjeshëm rrezikun e mashtrimit dhe forcojnë besimin e blerësve.

Ky propozim biznesi përmban edhe një analizë të detajuar kosto-përfitim të platformës FarmForce, duke ilustruar mënyrën se si një investim i tillë mund të nxisë rritjen afatgjatë, të përmirësojë konkurrueshmërinë dhe të sigurojë qasjen në tregjet ndërkombëtare. Përmes integritit të kësaj teknologjie, kompanitë shqiptare të fruta-perimeve dhe BMA-ve mund të rrisin cilësinë e produkteve të tyre, të përmbushin standardet globale dhe të pozicionohen strategjikisht për sukses të qëndrueshëm.

Në këtë analizë evidentohet platforma FarmForce për shkak të pjekurisë dhe performances së saj të konsoliduar, duke njohur dhe vlerësuar njëkohësisht edhe shfaqjen premtuese në treg të sistemit të gjurmueshmërisë zhvilluar nga Heliuss Systems. Duke pasur parasysh fazën e hershme të zhvillimit të saj, ky dokument ofron vetëm një pasqyrë të përgjithshme të këtij sistemi pa detajuar rezultatet financiare, pasi aktualisht mungojnë të dhënat e mjaftueshme për të kryer një vlerësim të besueshëm të kostove dhe përfitimit.

Konteksti

Shqipëria gëzon një traditë të pasur sa i takon prodhimit dhe eksportimit të bimëve mjekësore dhe aromatike (BMA). Historikisht, sektori ka qenë i përqendruar te BMA-të e egra të rritura në natyrë, por së fundmi po vërehet një tendencë në rritje drejt kultivimit të tyre, që konsiderohet si një praktikë më e qëndrueshme. Eksporti luan një rol vendimtar në këtë sektor, ku 95% të BMA-ve të prodhuara dërgohen jashtë vendit. Zinxhiri i vlerës dominohet nga 20-30 përpunues dhe eksportues të mëdhenj, por i gjithë procesi kërkon angazhim intensiv të fuqisë punëtore dhe mbështet rreth 80,000 familje, veçanërisht në zonat rurale dhe ato malore.

Pavarësisht zhvillimit dhe konsolidimit të vërejtur gjatë dekadës së fundit, ky sektori i BMA-ve vazhdon të mbetet i ndërlikuar, për shkak të përfshirjes së fazave të shumta, nga mbledhja dhe kultivimi e deri te përpunimi dhe tregtimi i produkteve. Për shumë familje rurale, vjelja e BMA-ve vazhdon të jetë një burim i rëndësishëm të ardhurash, megjithëse sot numri i familjeve të angazhuara është në rënie për shkak të ndryshimeve social-ekonomike në zonat malore. Megjithatë, BMA-të mbeten një pjesë e rëndësishme e ekonomisë shqiptare, duke përfaqësuar rreth 12% të eksporteve bujqësore të vendit. Në vitin 2023, sipas Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR), Shqipëria eksportoi rreth 50 milionë euro BMA të përpunuara dhe të papërpunuara, duke e renditur atë si eksportuesin e 16-të më të madh të BMA-ve në nivel global.

Sektori i BMA-ve vazhdon të ketë potencial për rritje. Me rritjen e kërkesës ndërkombëtare për transparencë, bizneset që mund të gjurmojnë BMA-të e tyre deri te burimi do të kenë përparësi në tregjet e nivelit të lartë. Nëpërmjet përdorimit të instrumenteve digjitale për dokumentimin dhe verifikimin e zinxhirit të furnizimit, kompanitë mund të lehtësojnë përmbushjen e kërkesave rregullore dhe forcojnë pozicionin e tyre konkurrues në treg. Digjitalizimi i proceseve, siç është gjurmimi i procesit të vjeljes së bimëve mjekësore dhe aromatike, mund të ulë numrin e gabimeve dhe të reduktojë mungesën e efikasitetit. Kjo qasje bën të mundur përmirësimin e operacioneve, si dhe ndihmon për ruajtjen e cilësisë së produktit, duke rritur të ardhurat dhe duke krijuar mundësi që kompanitë të zgjerohen në mënyrë sa më efektive.

Paralelisht, edhe sektori i frutave dhe perimeve (F&P) është shndërruar në një nga segmentët më dinamikë të bujqësisë shqiptare. Frutat dhe perimet e freskëta përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të eksporteve bujqësore—rreth 25–30% në vit—ku lista kryesohet nga domatet, specat, kastravecët, pjepri, agrumet dhe frutat e pyllit. Gjatë vitit 2023, Shqipëria eksportoi mbi 150 milionë euro në fruta dhe perime të freskëta, kryesisht drejt Italisë, Greqisë dhe tregjeve rajonale, me një prani gjithnjë e më të theksuar në tregjet e Evropës Qendrore dhe Perëndimore. Ky sektor përfiton nga faktorë të tillë si klima e favorshme e Shqipërisë, sezoni i gjatë i vjeljes dhe afërsia gjeografike me tregjet e BE-së, të cilët bëjnë të mundur që eksportuesit të arrijnë të furnizojnë tregjet me produkte më herët ose më vonë se konkurrentët e tyre.

Zinxhiri i vlerës për frutat dhe perimet paraqitet më i fragmentuar se zinxhiri i vlerës së bimëve mjekësore dhe aromatike (BMA), duke përfshirë mijëra fermerë të vegjël, por vitet e fundit kanë shënuar një konsolidim në rritje rreth prodhuesve më të mëdhenj, qendrave të grumbullimit dhe eksportuesve. Zgjerimi i certifikimit GlobalG.A.P. dhe i skemave të certifikimit në grup ka bërë të mundur rritjen e numrit të fermerëve që përmbushin standardet ndërkombëtare dhe që furnizojnë blerësit me vlerë të lartë. Edhe pjesëmarrja në panaire ndërkombëtare si Fruit Logistica ka kontribuar në rritjen e profilit të Shqipërisë, duke krijuar lidhje mes eksportuesve vendas dhe importuesve apo zinxhirëve të shitjes me pakicë në tregjet evropiane.

Megjithatë, sektori i frutave dhe perimeve (F&P) vazhdon të përballet me sfida. Trajtimi i produkteve pas vjeljes, magazinimi në kushte të ftohta dhe logjistika mbeten të pazhvilluara, duke kufizuar kështu aftësinë për të përmbushur në mënyrë të qëndrueshme kërkesat për cilësi. Eksportuesit përballen me trysni të shtuar për të garantuar gjurmueshmërinë, prodhimin pa mbetje kimike dhe furnizimin e sigurtë gjatë gjithë vitit, siç kërkohet nga blerësit e BE-së. Investimet për krijimin e serave moderne, sistemeve të ujitjes, platformave digjitale për gjurmueshmërinë e produkteve dhe modeleve të bujqësisë me kontratë po bëhen gjithnjë e më të rëndësishme për të garantuar konkurrueshmërinë në treg.

Të marra së bashku, bimët mjekësore dhe aromatike (BMA) dhe frutat e perimet (F&P) përfaqësojnë mundësi strategjike për Shqipërinë. Përmes forcimit të përputhshmërisë me standardet ndërkombëtare, investimeve në digjitalizim dhe gjurmueshmëri, si dhe orientimit drejt produkteve me vlerë të shtuar, eksportuesit mund të konsolidojnë pozicionin e tyre në tregjet premium dhe të zgjerojnë kuotën e tyre në kërkesën gjithnjë e më të madhe të Evropës për produkte bujqësore të qëndrueshme dhe me cilësi të lartë.



Vështrim i përgjithshëm mbi zgjidhjen: Qasje e besueshme për furnizimin e qëndrueshëm

FarmForce

FarmForce është një platformë digjitale që përmirëson menaxhimin e zinxhirëve të furnizimit në bujqësi, veçanërisht në sektorët që kërkojnë nivel të lartë gjurmueshmërie dhe kontrolli të cilësisë - siç janë fruta-perimet dhe bimët mjekësore dhe aromatike (BMA). Ajo i ndihmon bizneset për të monitoruar produktet e tyre nga faza e kultivimit e deri në përpunim dhe shitje, duke garantuar përputhshmërinë me standardet ndërkombëtare, skemat e certifikimit dhe kërkesat e blerësve.

Aktualisht, *FarmForce* është aktive në katër kontinente, në 32 vende dhe në 15 gjuhë të ndryshme. Ajo mbulon 27 lloje të kulturave bujqësore dhe përdoret nga mbi 1.4 milion fermerë në të gjithë botën. Kjo shtrirje e gjerë e bën platformën *FarmForce* një instrument të fuqishëm për përmirësimin e menaxhimit të fermave, garantimin e cilësisë së produkteve dhe promovimin e praktikave të furnizimit të qëndrueshëm.

Përfitimet kryesore

- **GJURMUESHMËRIA:** Çdo veprim në sistem lidhet me fermerë dhe parcela individuale, duke garantuar një rrugëtim të qartë dhe të gjurmueshëm nga ferma në treg.
- **PËRPUTHSHMËRIA ME STANDARDET:** *FarmForce* mbështet skemat e certifikimit si Global GAP dhe Organic, duke i ndihmuar bizneset të përmbushin kërkesat e tregjeve me vlerë të lartë.
- **QËNDRUESHMËRIA:** Me mbi 1.1 milion parcela të hartëzuara, platforma mbështet monitorimin mjedisor dhe gjurmimin e shpyllëzimit.
- **EFIKASITETI:** Të dhënat në kohë reale dhe arkivimi digjital i të dhënave përmirësojnë mbikëqyrjen operacionale dhe vendimmarrjen.

Mbështetja për Sektorin e Fruta-Perimeve dhe BMA-ve

Në sektorët e fruta-perimeve dhe bimëve mjekësore dhe aromatike (BMA), platforma FarmForce luan një rol vendimtar për menaxhimin e fermerëve të vegjël dhe të grumbulluesve. Ajo thjeshton koordinimin, garanton cilësinë dhe qëndrueshmërinë në çdo fazë dhe i mbështet kompanitë për të përmbushur kërkesat për eksportimin e tyre.

Veçoritë kryesore specifike për BMA-të përfshijnë:

- **TË DHËNAT NË KOHË REALE PËR PRODHIMIN:** Monitoron lëndët hyrëse (inputet), ecurinë e kulturave dhe aktivitetet për vjeljen e tyre për të përmirësuar rendimentin dhe për të planifikuar punën paraprakisht.
- **GJURMUESHMËRIA E DETAJUAR:** Ndhmon bizneset të përmbushin standardet e certifikimit, duke hapur dyert drejt tregjeve të nivelit të lartë.
- **PËRGATITJA PËR CERTIFIKIMIN:** Helps businesses comply with certification standards, opening doors to premium markets.
- **QASJA E PËRMIRËSUAR NË TREG:** Duke përmirësuar gjurmueshmërinë dhe përputhshmërinë me standardet, FarmForce i ndihmon bizneset e BMA-ve të jenë më konkurruese dhe më të besueshme në sytë e blerësve globalë.

Ndikim transformues mbi kompanitë shqiptare

Për kompanitë shqiptare, FarmForce sjell një avantazh të dukshëm konkurrues në tregun e fruta-perimeve dhe BMA-ve. Duke forcuar gjurmueshmërinë dhe përputhshmërinë me standardet, ajo konsolidon reputacionin e kompanisë si një ofrues i besueshëm i produkteve cilësore. Kjo jo vetëm që ndihmon në krijimin e besimit tek blerësit, por nxit edhe kryerjen e investimeve dhe krijon mundësi për zgjerimin e tregut. FarmForce kontribuon në promovimin e imazhit të Shqipërisë si një vend që garanton standarde të larta në praktikën bujqësore dhe eksportet.

Si funksionon *FarmForce*: Pjesët Përbërëse dhe Veçoritë Kryesore

- **NUMËR UNIK IDENTIFIKIMI (ID) PËR FERMERIN:** Çdo fermer pajiset me një identifikues unik, me profile të detajuara që përfshijnë emrin, datëlindjen, gjininë, të dhënat e kontaktit, fotografi dhe informacione të tjera shtesë.
- **LIDHJA ME PARCELAT:** Këtu fermerët lidhen me një ose më shumë parcela, secila me një ID unike të parcelës. Të dhënat e parcelave mund të importohen përmes formatit shapefile ose të hartëzohen drejtpërdrejt përmes aplikacionit celular.
- **PANELI I KONTROLLIT TË FERMERËVE:** Këtu ofrohet një pasqyrë e plotë e aktiviteteve të fermerëve, duke përfshirë parcelat e hartëzuara, ciklet e kulturave, trajnimet e ndjekura dhe historikun e pagesave.
- **PANELI I KONTROLLIT TË FERMERËVE:** Këtu ofrohet një pasqyrë e plotë e aktiviteteve të fermerëve, duke përfshirë parcelat e hartëzuara, ciklet e kulturave, trajnimet e ndjekura dhe historikun e pagesave.

- **GJURMIMI I AKTIVITETIT TË FERMERËVE:** Këtu menaxhohet me lehtësi angazhimi sezonal - identifikohen fermerët që janë joaktivë pa fshirë të dhënat e tyre nga sistemi.
- **ETIKETAT:** Këtu identifikohen shpejt fermerët në bazë të karakteristikave të veçanta, si pjesëmarrja në programe të tilla si Rainforest Alliance.
- **GRUPET:** Këtu fermerët organizohen në grupe të lidhura me punonjës, fushata ose anketa të caktuara për menaxhimin sa më efikas të tyre.
- **ATRIBUTET E EMËRTUARA:** Këtu ngarkohen fushat e të dhënave të personalizuara të kërkuara nga klientët, si historiku i prodhimit ose mosha e parcelave.
- **HARTËZIMI I PARCELAVE DHE INFRASTRUKTURËS:** Këtu hartëzohen pikat referuese si ato bujqësore ashtu edhe ato jobujqësore (p.sh., pyjet, shkollat) në afërsi të fermave të menaxhuara.
- **HARTËZIMI I PARCELAVE ME GPS:** Këtu krijohen dhe arkivohen poligonet e lokalizuara përmes GPS-it për parcelat, për të ndjekur me saktësi vendndodhjen dhe marrëdhëniet hapësinore të tyre.

Helius Systems – Një Zgjidhje Lokale për Sigurinë Ushqimore dhe Gjurmueshmërinë

Ndërsa platformat e njohura në nivel ndërkombëtar si FarmForce ofrojnë zgjidhje të provuara tashmë në lidhje me gjurmueshmërinë e zinxhirit të furnizimit, në Shqipëri është konstatuar edhe zhvillimi i sistemeve lokale inovative të përshtatura për kontekstin specifik të vendit. Një prej këtyre zgjidhjeve është zhvilluar nga Helius Systems me mbështetjen e projektit të punësimit të të rinjve nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC, zbatuar nga Helvetas dhe PartnersAlbania (RisiAlbania). Helius Systems është një kompani teknologjike shqiptare pioniere, e cila ofron një platformë digjitale për gjurmueshmërinë të fokusuar në sigurinë ushqimore dhe transparencën e zinxhirit të furnizimit, veçanërisht të rëndësishme për sektorin e Fruta-Perimeve (F&P) dhe Bimëve Mjekësore dhe Aromatike (BMA).

Sistemi digjital i kompanisë Helius Systems për Sigurinë Ushqimore dhe Gjurmueshmërinë është projektuar për të ndihmuar bizneset në punën e tyre për monitorimin, menaxhimin dhe dokumentimin e rrugëtimit të produkteve të tyre nga origjina e deri në destinacionin përfundimtar. Megjithëse ende i ri në treg dhe pa të dhëna të plota mbi performancën financiare në shkallë të gjerë, ky sistem përfaqëson një alternativë premtuese vendase ndaj platformave ndërkombëtare.

Veçoritë dhe Përfitimet Kryesore

1	2	3	4	5
<p>Regjistrat Digjitalë dhe Transparenca në të Gjithë Zinxhirin e Furnizimit.</p> <p>Helius mundëson gjurmimin elektronik të produkteve në të gjithë zinxhirin e furnizimit, duke ofruar një tablo të qartë dhe në kohë reale të çdo hapi në procesin e prodhimit dhe shpërndarjes.</p>	<p>Siguria dhe Integriteti i të Dhënave.</p> <p>Platforma përdor teknologji të sigurt dhe rezistente ndaj manipulimeve për të ruajtur saktësinë dhe vërtetësinë e të dhënave, duke forcuar besimin dhe duke zvogëluar rrezikun e mashtrimit.</p>	<p>Reagim i Shpejtë.</p> <p>Në rast problemesh me sigurinë ushqimore, sistemi i gjurmueshmërisë ndihmon në identifikimin e shpejtë të burimit të kontaminimit, duke bërë të mundur marrjen e masave të menjëhershme për të minimizuar rreziqet për shëndetin dhe për të parandaluar përhapjen e mëtejshme.</p>	<p>Pajtueshmëria Rregullatore</p> <p>Helius është ndërtuar për të mbështetur pajtueshmërinë me rregulloret e sigurisë ushqimore si të Shqipërisë ashtu edhe të Bashkimit Evropian, duke e bërë atë të përshtatshëm për kompanitë që synojnë tregjet vendase dhe ato ndërkombëtare.</p>	<p>Përmirësimi i Cilësisë së Produktit dhe Rritja e Përgjegjshmërisë.</p> <p>Duke dokumentuar çdo fazë të zinxhirit të prodhimit, sistemi i nxit bizneset të respektojnë standarde më të larta dhe promovon kulturën e transparencës dhe të sigurimit të cilësisë.</p>

Gjurmueshmëria Digjitale: Pse Ka Rëndësi?

- **INFORMACIONE TË DOMOSDOSHME.** Operacionet e mëdha bujqësore përfshijnë një numër të madh fermerësh. Për të mundësuar shkallëzimin e çdo parcele, fermeri ose produkti, nevojiten të dhëna të sakta në nivel ferme, pasi pa një informacion të tillë nuk është e mundur të garantohet gjurmueshmëria.
- **VENDIMMARRJA CILËSORE.** Digjitalizimi dhe optimizimi i proceseve përgjatë gjithë rrugëtimit të produktit, duke filluar nga niveli i fermës, së bashku me të dhënat e sakta në bazat e të dhënave online, rrisin aftësinë për zbutjen e rezeqeve dhe përmirësimin e marzheve të fitimit.
- **RITJIA E VIZIBILITETIT TË MARKËS.** Gjatë gjithë zinxhirit të furnizimit dhe deri te konsumatori fundor, transparencja dhe qasja te operacionet e fermerëve dhe parcelave si dhe gjurmueshmëria që lidhet me hartëzimin përmes aplikacionit GPS, po bëhen gjithnjë e më të kërkuara.
- **RESPEKTIMI I RREGULLOREVE KOMBËTARE PËR GJURMUESHMËRINË.** Përdorimi i sistemeve të gjurmueshmërisë si FarmForce ose ai i zhvilluar në nivel lokal nga Helius Systems, u jep kompanive shqiptare një avantazh të rëndësishëm lidhur me përgatitjen e nevojshme për t'u përputhur me kërkesat e reja për gjurmueshmërinë të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural të përcaktuara në Direktivën Nr. 15, Datë 10.04.2025: "Për treguesit ose shenjat që identifikojnë lotin të cilit i përket një produkt ushqimor". Kjo direktivë do të hyjë në fuqi më 1 janar 2026, ndaj ky është momenti i duhur që kompanitë shqiptare të nisin përgatitjet për zbatimin e saj.

UDHËRRËFYESI I ZBATIMIT



Vlerësimi i Nevojave & Vendosja e Objektivave

- Analizimi i sistemit aktual, identifikimi i mangësive, përcaktimi i objektivave



Hartëzimi i Zinxhirit të Furnizimit

- Identifikimi i fazave kryesore dhe pikave për kapjen e të dhënave



Përzgjedhja e Zgjidhjes për Gjurmueshmërinë

- Zgjedhja e sistemit më të përshtatshëm të gatshëm për përdorim ose të zhvilluar posaçërisht sipas nevojës



Konfigurimi i Infrastrukturës Digjitale

- Instalimi i pajisjeve, garantimi i ruajtjes në cloud, sigurimi i lidhshmërisë



Trajnimi i Stafit & Palëve të Interesuara

- Zhvillimi i seancave të trajnimit, përcaktimi i PSO-ve



Mbledhja & Integrimi i të Dhënave

- Nisja e mbledhjes së të dhënave në kohë reale, integrimi me sistemet



Faza e Testimit & Pilotimit

- Verifikimi i saktësisë, përdorshmërisë, marrja e përshtypjeve



Certifikimi & Shfrytëzimi i Tregut

- Marrja e certifikimeve, gjurmueshmëria e tregut deri te blerësit

Aspektet e tregut

Tregu global për bimët mjekësore dhe aromatike (BMA) është vlerësuar në 9-10 miliardë dollarë në vitin 2023 dhe parashikohet të rritet me 6-7% në vit gjatë viteve në vijim, duke kapur vlerën prej 14-16 miliardë dollarësh deri në vitin 2030. Kjo rritje do të nxitet nga kërkesa gjithnjë e më e madhe për përbërës natyralë në produktet farmaceutike, kozmetike dhe ushqimore, si dhe nga preferenca në rritje e konsumatorëve për produkte organike dhe të qëndrueshme. Eksportuesit shqiptarë janë në një pozicion të favorshëm për të përfituar nga këto tendencarende, veçanërisht në tregjet me vlerë të lartë si Gjermania, SHBA-ja, Franca dhe Italia, që renditen ndër importuesit më të mëdhenj në botë të produkteve të BMA-ve. Aktualisht, një numër i konsiderueshëm kompanish ndërkombëtare blejnë BMA të prodhuara në Shqipëri.

Një faktor i rëndësishëm që nxit rritjen është ndërgjegjësimi gjithnjë e më i madh në lidhje me përfitimet shëndetësore që burojnë nga BMA-të si sherbela, rigoni, kamomili dhe trumza, të cilat përdoren gjerësisht në çajra bimorë, suplemente dhe ushqime funksionale. Edhe industritë farmaceutike dhe kozmetike po përballen me një kërkesë në rritje për BMA-të, veçanërisht për vajrat esencialë, ekstraktet bimorë dhe suplementet dietike. Për eksportuesit shqiptarë, përmbushja e standardeve të certifikimit organik dhe standardeve ndërkombëtare të cilësisë është vendimtare për të fituar dhe ruajtur praninë në tregjet e nivelit të lartë. Përdorimi i sistemeve të gjurmueshmërisë si FarmForce po bëhet gjithnjë e më i rëndësishëm për përmbushjen e pritshmërive të blerësve globalë.

Ndërsa përpunuesit dhe eksportuesit shqiptarë përballen me konkurrencën nga vendet fqinje me klimë të ngjashme, si dhe nga vende si Spanja dhe Maroku, biodiversiteti i saj i pasur dhe cilësia e lartë e bimëve aromatike dhe mjekësore i japin Shqipërisë një avantazh konkurrues. Duke investuar për procesin e kultivimit dhe duke u fokusuar tek produktet me vlerë të shtuar, siç janë vajrat esencialë dhe produktet e paketuara të gatshme për shitje me pakicë, eksportuesit shqiptarë mund të diferencohen edhe më tej në tregjet ndërkombëtare. Me përdorimin në rritje të BMA-ve në produktet nutraceutike dhe farmaceutike, këta eksportues kanë potencial të konsiderueshëm për të zgjeruar kuotën e tyre në treg.

Në të njëjtën kohë, edhe tregu global i frutave dhe perimeve të freskëta (F&P) përfaqëson një mundësi shumë më të madhe. Me një vlerë prej më shumë se 1.3 trilion dollarësh në vitin 2023, sektori pritet të vazhdojë të rritet me rreth 5% në vit deri në vitin 2030, i nxitur nga konsumimi global në rritje i ushqimeve të freskëta dhe të shëndetshme, urbanizimi dhe kërkesa gjithnjë e më e madhe për furnizim të vazhdueshëm gjatë gjithë vitit në tregjet e zhvilluara. Vetëm Bashkimi Evropian importon mbi 20 miliardë euro në vit fruta dhe perime të freskëta, ku Gjermania, Holanda, Franca dhe Italia përbëjnë pikat kryesore të hyrjes dhe konsumit.

Për Shqipërinë, afërsia me tregjet e BE-së si dhe kalendarët konkurrues të vjeljes krijojnë mundësi të favorshme për zgjerimin e eksporteve të frutave dhe perimeve, veçanërisht për produkte të tilla si domatet, specat, kastravecët, pjepri, agrumet dhe frutat e pyllit. Shqipëria ka shënuar përparim të dukshëm në përafrimin me standardet e cilësisë dhe të sigurisë ushqimore të BE-së, dhe zgjerimi i certifikimit GlobalG.A.P. së bashku me skemat e certifikimit në grup kanë kontribuar në rritjen e numrit të prodhuesve me qasje të blerësit premium. Pjesëmarrja në panairë ndërkombëtare si Fruit Logistica në Berlin e ka rritur më tej dukshmërinë e Shqipërisë dhe ka krijuar lidhje mes eksportuesve vendas dhe blerësve globalë.


Për të ruajtur konkurrueshmërinë, eksportuesit shqiptarë të frutave dhe perimeve duhet të forcojnë trajtimin e produkteve pas vjeljes, kapacitetet e magazinimit në kushte të ftohta, logjistikën dhe markimin, pasi blerësit kërkojnë gjithnjë e më shumë besueshmëri, gjurmueshmëri dhe cilësi të qëndrueshme. Edhe investimet për përdorimin e metodave të qëndrueshme të prodhimit dhe të modeleve të bujqësisë me kontratë po kthehen në faktorë kyç për sigurimin e furnizimit pa ndërprerje me produkte të partnerëve ndërkombëtarë. Me rritjen e kërkesës në tregjet rajonale dhe në tregjet e BE-së për fruta dhe perime të freskëta organike, pa mbetje kimike dhe të prodhuara në mënyrë të qëndrueshme, Shqipëria ka potencial të konsiderueshëm për të rritur eksportet dhe për të përfaqësuar një pjesë më të madhe të segmentit të tregut me vlerë të lartë.

5

Mundësitë në nivel biznesi

Duke pasur parasysh konkurrencën në tregtinë ndërkombëtare, përmirësimi i gjurmueshmërisë është një hap i domosdoshëm për përpunuesit dhe eksportuesit e fruta-perimeve dhe BMA-ve në Shqipëri për të pasur qasje të qëndrueshme në tregjet me vlerë të lartë, si dhe për të përfituar nga rritja e parashikuar vjetore e tregut prej 6-7% (BMA) dhe akoma më e lartë për fruta-perimet në 5-6 vitet e ardhshme. Edhe kërkesat e blerësve për transparencë dhe praktika të qëndrueshme janë në rritje të vazhdueshme. FarmForce e adreson këtë nevojë duke ofruar një sistem të sigurt që regjistron çdo hap të zinxhirit të furnizimit, duke lehtësuar përputhshmërinë me standardet e BE-së dhe ato globale. Ky nivel gjurmueshmërie kontribuon edhe për zbutjen e risqeve, duke i ndihmuar kompanitë që të menaxhojnë me shpejtësi problemet e mundshme të kontaminimit që çojnë në tërheqje të produkteve nga tregu, duke mbrojtur kështu reputacionin e markës së tyre dhe duke u përkthyer në marzhe më të larta fitimi.

Figura 1: Përfitimet financiare në EURO që burojnë nga përdorimi i platformës FarmForce



Përdorimi i platformës *FarmForce* është duke ndjekur një trajektore të qartë tashmë, ku shembulli i suksesshëm në Shqipëri shërben si pikë konkrete referimi. Investimi fillestar është relativisht i ulët, ndërsa kthimi nga investimi (ROI) rezulton të jetë mjaft i kënaqshëm, duke e bërë përfitimin plotësisht të justifikuar në raport me përpjekjen e nevojshme për futjen në përdorim të kësaj platforme.

Përfitimet financiare janë të dukshme. *FarmForce* përmirëson cilësinë e përgjithshme të produktit, zvogëlon humbjet dhe rastet e tërheqjes së produkteve nga tregu, thjeshton proceset e certifikimit dhe rrit efikasitetin operacional të eksportuesve. Këto përmirësime çojnë drejtpërdrejt në përfitime të konsiderueshme financiare.

Tabela 1: Përfitimet financiare në EURO që burojnë nga përdorimi i platformës *FarmForce*

Zërat e shpenzimeve*	Viti 1	Viti 2	Viti 3
Tarifa (vjetore) për licencimin e softuerit	4,000	4,000	4,000
Tarifat e para-auditimit dhe të auditimit	4,000	4,000	4,000
Kostoja e konsulencës për zbatimin (rrjeti i 350 fermerëve)	8,000	6,000	5,000
Kostot shtesë për fuqinë punëtore	10,000	11,000	12,000
Tarifa vjetore për mirëmbajtjen	1,000	1,000	1,000
Kostot e pajisjeve (tableta, telefona inteligjentë)	2,000	0	0
Trajnimi dhe orientimi fillestar	5,000	0	0
Kostot shtesë (internet, të dhëna, etj.)	1,000	1,000	1,000
Shpenzimet totale në lidhje me zbatimin	35,000	27,000	27,000
Përfitimet (xhiro/qarkullim shtesë për shkak të përdorimit të <i>FarmForce</i>)			
Xhiroja vjetore 2023	2,000,000	2,100,000	2,205,000
Rritja e parashikuar e xhiros për shkak të përdorimit të <i>FarmForce</i>	100,000	105,000	110,250
<i>Përfitime të tjera financiare</i>	<i>20,000</i>	<i>20,000</i>	<i>20,000</i>
- Ulja e rasteve të humbjes dhe tërheqjes së produkteve nga tregu	10,000	10,000	10,000
- Thjeshtimi i certifikimit dhe përputhshmërisë me standardet	5,000	5,000	5,000
- Përmirësimi i efikasitetit të zinxhirit të furnizimit	5,000	5,000	5,000
Përfitimet totale financiare	120,000	125,000	130,250
Të ardhura shtesë	85,000	98,000	103,250
Kthimi nga Investimi (ROI)	242.9%	363.0%	382.4%

Kjo analizë shqyrton ndikimin financiar të gjeneruar nga përdorimi i platformës FarmForce për një eksportues të vogël ose të BMA-ve me shitje vjetore prej 2 milionë eurosh. Përdorimi i FarmForce mund të rrisë shitjet me të paktën 5%, ndërkohë që zvogëlon humbjet e prodhimit dhe rastet e tërheqjes së produkteve nga tregu, thjeshton procesin e certifikimit dhe përmirëson efikasitetin e zinxhirit të furnizimit. Investimi në FarmForce siguron një kthim të investimit (ROI) prej 2.42 në vitin e parë, 3.63 në vitin e dytë dhe 3.82 në vitin e tretë, që do të thotë se për çdo euro të investuar, eksportuesi fiton të paktën 2.42 euro në vitin e parë dhe 3.82 në vitin e tretë. Pra, menjëherë pas thjeshtimit të proceseve dhe fitimit të përvojës nga ekipi për përdorimin e platformës FarmForce, kthimi nga investimi rritet si rezultat i të ardhurave shtesë më të larta dhe kostove më të ulëta të sistemit në vitet në vijim. Edhe shpenzimet për konsulencë zvogëlohen, pasi sistemi është tashmë funksional dhe kapacitetet e brendshme janë përforcuar. Investimet për pajisjet, trajnimin dhe orientimin fillestar janë të nevojshme vetëm gjatë vitit të parë, duke qenë se po konsiderohet një numër konstant fermerësh. FarmForce ofron një rrugëtim të qartë dhe të provuar drejt gjurmueshmërisë, me rezultate të prekshme si në aspektin operacional ashtu edhe financiar për eksportuesit.

Nëse synoni të nisni punën për realizimin e gjurmueshmërisë digjitale, është e rëndësishme që të përcaktoni me kujdes procesin e strukturuar hap pas hapi që do të ndiqni.



Histori sukcesi

RisiAlbania ka bashkëpunuar me kompaninë Albanian Herb, një nga eksportuesit kryesorë të bimëve mjekësore dhe aromatike (BMA) në Shqipëri, për të pilotuar përdorimin e platformës FarmForce në kompaninë e tyre dhe në grupin e fermerëve të angazhuar në kultivimin e rignonit.

Partneriteti i projektit RisiAlbania me Albanian Herb për të pilotuar platformën FarmForce brenda rrjetit të tyre shënon një hap të rëndësishëm për sektorin e bimëve mjekësore dhe aromatike (BMA) në Shqipëri. Përmes përdorimit të FarmForce - një zgjidhje digjitale për menaxhimin dhe monitorimin e aktiviteteve bujqësore – kompania Albanian Herb synon të përmirësojë gjurmueshmërinë dhe sigurimin e cilësisë së rignonit shqiptar. Kjo iniciativë jo vetëm që ka forcuar prodhimin dhe qëndrueshmërinë e kësaj bime, por ka hapur edhe rrugën për markimin dhe promovimin e rignonit shqiptar si një produkt cilësor në tregun amerikan.

Shqipëria njihet tashmë në SHBA për eksportet e saj të sherbelës tejet cilësore, dhe përdorimi i Farmforce i ndihmon kompanitë shqiptare të përmbushin rregulloret e BE-së dhe të pozicionojnë edhe rignonin shqiptar së bashku me sherbelën si një bimë me cilësi të lartë me karakteristika unike. Kjo iniciativë ka dëshmuar potencialin e sektorit të BMA-ve për të diversifikuar dhe zgjeruar eksportet e tij, duke forcuar reputacionin e Shqipërisë si një burim i besueshëm i bimëve mjekësore me cilësi të lartë dhe origjinë organike në tregjet globale.

Zbatimi i programit pilot me kompaninë Albanian Herb ka evidentuar përmirësimin e konsiderueshëm të aspekteve të tilla si gjurmueshmëria, efikasiteti operacional dhe menaxhimi i certifikimeve. Kompania ka filluar të përdorë platformën FarmForce me 350 fermerë dhe ka arritur të krijojë 20 vende të reja pune në rrjetin e saj të bashkëpunimit.

Përmes përdorimit të FarmForce, kompania ka arritur të realizojë gjurmueshmërinë e plotë për produktet e grumbulluara nga 350 fermerë. Proceset e certifikimit u thjeshtuan, duke zvogëluar kështu kohën e përgatitjes për auditim me 50%. Kompania ka regjistruar një përmirësim prej 20% në punën për planifikimin dhe koordinimin e vjeljes së rignonit, duke çuar në uljen e humbjeve pas vjeljes. Gjurmueshmëria dhe koordinimi më i mirë me fermerët sollën rritjen e cilësisë dhe të sasisë së produktit, duke gjeneruar të ardhura shtesë prej 60 mijë EUR nga prodhimi prej 600 tonësh rigon. Gjithashtu, kompania arriti të paguajë fermerët me një çmim më të lartë, duke gjeneruar rreth 40 mijë EUR në nivel ferme.

Thirrje për veprim

Për të mbetur konkurrues në tregun global dhe për të rritur fitimet, eksportuesit shqiptarë të fruta-perimeve dhe BMA-ve duhet të investojnë në sistemet digjitale të gjurmueshmërisë. Instrumentet digjitale ndërkombëtare si FarmForce janë tejet të rekomandueshme. Për kompanitë që e konsiderojnë FarmForce të ndërlikuar apo me kosto të lartë, një alternativë e përshtatshme është sistemi i gjurmueshmërisë, zhvilluar nga Heliuss System, me seli në Tiranë, e cila ofron një zgjidhje më të thjeshtë dhe më të aksesueshme për gjurmueshmërinë. Këto instrumente ndihmojnë për përmbushjen e kërkesës në rritje për gjurmueshmëri, përputhshmëri rregullatore dhe efikasitet. Fillimisht, kompanitë e interesuara mund ta testojnë platformën FarmForce në një pjesë të vogël të zinxhirit të tyre të furnizimit, për të vlerësuar përfitimet praktike përpara se të kalojnë në zbatimin më të gjerë të saj.

Adoptimi i platformës FarmForce nuk përbën thjesht një hap drejt digjitalizimit; ajo përbën një zgjedhje të zgjuar për suksesin afatgjatë. Duke përmirësuar gjurmueshmërinë dhe duke thjeshtuar operacionet, eksportuesit e fruta-perimeve dhe BMA-ve mund të hapin mundësi të reja tregu dhe të forcojnë pozicionin e tyre në tregun global.

Një projekt nga Agjencia
Zvicerane për Zhvillim dhe
Bashkëpunim SDC



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim
dhe Bashkëpunim SDC

**PËRSHPEJTIMI I RRRITJES
NË SEKTORIN E FRUTA-PERIMEVE
DHE BMA-ve NË SHQIPËRI PËRMES
GJURMUESHMËRISË DIGJITALE**

Në partneritet me:



Zbatuar nga:



HELVETAS



PARTNERSALBANIA
FOR CHANGE AND DEVELOPMENT